



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "GSG" Sh.P.K. të datës 07.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "GSG" Sh.P.K. e datës 07.02.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "ENGROUP" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "GSG" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 07.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në lagjen Kalabria - Ritender" me nr. të prokurimit 616-24-219-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:** *“Kërkesat duhen rishikuar dhe përshtatur në përputhje me nevojat konkrete të kontratës për ndërtimin e shkollës. Meqenëse kriteret aktuale përfshijnë kërkesa të dyfishta për inxhinierin e hidroteknikës dhe teknikëve ndërtimorë është e nevojshme largimi i njërit prej tyre për të siguruar që kriteret janë të qarta dhe të nevojshme për realizimin e projektit. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerë minimale 3.000.000,00 euro në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontrate. Te kete min. nje shkolle me salle te sportit ne vlerë min 2,5 mil EUR. Ne rast te GOE, lideri duhet te plotesoje 70% të kërkesave. Kërkojme qe kërkesa: Te kete min. nje shkolle me salle te sportit ne vlerë min 2,5 mil EUR. Ne rast te GOE, lideri duhet te plotesoje 70% të kërkesave ,te largohet si kerkese nga dosja e tenderit dhe njoftimit per kontrate sepse eshte kerkes e tepert e kufizon konkurrencen si dhe diskrimion nje apo me shume operatore ekonomik te interesuar per pjesmarrje ne kete aktivitet te prokurimit. Per të gjithë diplomat-kualifikimet e arritura është kërkuar dëshmi Diploma (kopje e noterizuar në Republikën e Kosovës. OE duhet te posedoje mjete , stabilimente dhe paisje teknik qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizmi i obligueshem sipas aneksit 8 te DT. Sa i perket paisjeve duhet riformuluar kërkesat”.*

**Sa i përket pretendimeve ankimore,** duhet cekur se te pika ku kërkohet të dëshmohet se është përfunduar min. një projekt shkollë me sallë të sportit në vlerë min. 2,5 mil. euro mjafton që të riformulohet ashtu që të kërkohen vetëm projekte të natyrës së ngjashme ku së paku njëra prej tyre duhet të jetë me min. 2,5 mil. euro.

Sa i përket kërkesës për noterizimin e dokumenteve duhet cekur se kërkesa në dosjen e tenderit i referohet kualifikimeve përkatësisht diplomave të arritura jashtë Republikës së Kosovës. Në këtë rast është e domosdoshme që të dëshmohet nostrifikimi i diplomës së huaj në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MASHT) nr. 12-2018 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës. Pra në rastin konkret në vend se të përdoret termi “nostrifikim” është përdorur termi “noterizim” në mënyrë të gabuar në dosjen e tenderit.

Sa i përket pikave tjera ankimore parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument të qëndrueshëm për të mbështetur pretendimet ankimore. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente për të mbështetur vetëm pjesërisht pretendimet ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar vetëm si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.02.2024

**Visar SHEHU**  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.